



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr.144/1 Prot.

Tiranë, më 20.06.2016

V E N D I M

Nr. 70, datë 20/06/2016

"Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Shkodër"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë "*Mbi verifikimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 34, datë 22.04.2015 "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Shkodër"*",

Vërejtje se:

Në zbatim të Vendimit nr. 6, datë 28.01.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Shkodër*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 34, datë 22.04.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Shkodër*", në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia Përgjegjëse (Drejtoria e Burimeve Njerëzore), në zbatim të nenit 128, të ligjit nr.8485, dt.12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimin, për punonjësen *****, në pozicionin "*Specialiste e Buxhetit dhe Shpenzimeve*" dhe për punonjësen *****, në pozicionin "*Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe*

Kontabilitetit”, duke shtuar faktin që punonjësit duhet të konsiderohen në periudhë prove.

Njësia përgjegjëse të marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikohen për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj, të shprehet për konfirmimin ose jo në këto pozicione.

3. Njësia përgjegjëse, të nxjerrë Aktin e Deklarimit të Statusit për punonjësin *****, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”, për punonjësin *****, në pozicionin “*Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*” dhe për punonjësin *****, në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës*”.
4. Njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktin e deklarimit të statusit si nëpunës civil për punonjësin *****, duke evidentuar faktin se pozicioni i punës “*Zëdhënës, Këshilltar i Marëdhënieve me Jashtë*”, nuk futet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Nëse institucioni pretendon se ky pozicion është pjesë e shërbimit civil, duhet të bëjë njehsimin e këtij pozicioni me emërtesat dhe klasat e nëpunësisë civile.

5. Njësia përgjegjëse duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, për punonjësit *****, emëruar me Urdhrin e Brendshëm nr. 1/22, datë 01.02.2001 në pozicionin “*Inspektor Mjedisi*”, *****, emëruar me Urdhrin e Brendshëm nr. 11, datë 03.02,2009 në pozicionin “*Specialist IT në Sektorin e Shërbimeve të Brëndshme*” dhe *****, emëruar me Urdhrin e Brendshëm nr. 518, datë 01,02,2006 në pozicionin “*Specialiste Arkiv/Protokoll*”, duke evidentuar faktin se nuk i përmbushin kriteret për të qënë nëpunës civilë dhe pozicionet e punës të shpallen të lira për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.
6. Të sqarohet situata në lidhje me aktin administrativ, “*Urdhri i Brendshëm, nr. 31, datë 10,12,2014, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut*” në lidhje me pezullimin e përkohshëm nga detyra të punonjësve ***** dhe *****, përkatësisht në pozicionet e punës “*Drejtor*” dhe “*Specialist*” në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës. Në kushtet konkrete, ky akt ka dalë në kundërshtim me ligjin e me procedurat ligjore që rregullojnë institutin e pezullimit, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë për zbatim të tij
7. Drejtoria e Burimeve Njerëzore,duhet të revokojë aktin e emërimit për punonjësin *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë*” dhe të vijojnë procedurat për plotësimin e tij në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë proces.
8. Njësia përgjegjëse të informojë Komisionerin për ecurinë e procesit të ristrukturimit, duke e njohur me strukturën e re, si dhe me të gjithë procedurën që e ka shoqëruar atë.

9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve në vendimin e mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Vendimin nr.34, datë 22.04.2015.

Me Urdhrin nr.144, datë 17.02.2016, të Komisionerit u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin, Këshilli i Qarkut Shkodër në datën 19.02.2016 dhe i kërkoi personit përgjegjës, nëpunësit ***** , dosjet e personelit dhe dokumentacionin shkresor të dalë në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 2 të vendimit, njësia përgjegjëse në zbatim të nenit 128, të ligjit nr.8485, dt.12.05.1999 “ Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit duke nxjerrë aktin e deklaramit si nëpunëse civile në periudhë prove nr.489/23, datë 08.05.2014, për nëpunësen ***** , në pozicionin “specialiste” në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës. Pozicioni “Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Kontabilitetit” që mbante nëpunësja ***** nuk ekziston më në strukturën organike për vitin 2015 e për rrjedhojë njësia përgjegjëse nuk është shprehur për këtë punonjëse, e cila është liruar nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 3 të vendimit, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për punonjësit e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës e konkretisht: Akti nr.489/30, dt.08.05.2014, për deklaramin si nëpunës civil të punonjësit ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”; Akti nr.489/31, dt.08.05.2014, për deklaramin si nëpunës civil të punonjësit Islam Semanaj në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”; Akti nr.489/32, dt.08.05.2014, për deklaramin si nëpunës civil të punonjësit ***** në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 4, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit, në strukturën e vitit 2016, është njehsuar pozicioni i nëpunësit ***** me emërtesat dhe klasat e nëpunësisë civile sipas parashikimeve të nenit 19 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nga emërtesa “Zëdhënës,Këshilltar i Marrëdhënieve me Jashtë”, është emëruar “Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Komunikimit dhe Informacionit”.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 5 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse me aktin nr.6, dt.06.03.2015 ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me punonjësin ***** me detyrë “Inspektor mjedisi”; me aktin nr.7, dt.06.03.2015 ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me punonjësin ***** me detyrë “Specialist i teknologjisë së

informacionit” dhe sipas procesverbalit të datës 19.02.2016 dhe sipas Vendimit nr.4, datë 30.01.2016 “*Mbi strukturën organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*”, presupozohet e ndërprerë marrëdhënia e punësimit me punonjësin ***** me detyrë “*specialiste arkiv-protokolli*”, sepse ky pozicion pune nuk ekziston më në strukturën e re.

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 6 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse me aktin administrativ nr.35, dt.23.12.2014, ka revokuar Urdhrin e Brendshëm nr.31, dt.10.12.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe ka vendosur rifillimin e marrëdhënies së punësimit për nëpunësin ***** me detyrë “*Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës* “ dhe me aktin administrativ nr.17, dt.17.06.2015, ka revokuar Urdhrin e Brendshëm nr.31, dt.10.12.2014 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe ka vendosur rifillimin e marrëdhënies së punësimit për nëpunësin ***** me detyrë “*Drejtor në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës* “.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 7 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse me Urdhrin nr.2, datë 29.01.2015, e ka emëruar punonjësin ***** në detyrën “*Specialist i mesëm topograf*” në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pozicion pune jashtë fushës së veprimit të shërbimit civil.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 8 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse e ka njohur Komisionerin me Strukturën e re të miratuar për vitin 2016.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 34, datë 22.04.2015 “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Shkodër*”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Këshilli i Qarkut Shkodër**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Këshilli i Qarkut Shkodër.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 34, datë 22.04.2015 “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Shkodër*”.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Këshilli i Qarkut Shkodër, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA